



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORATI

Nr. 383 Prot.

Gjirokastrë, më 05.03.2025

Lënda: Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ me partneritetin INTERCON, Spanjë.

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë hap thirrjen për shkëmbim stafi akademik dhe administrativ, në kuadër të Javës Ndërkombëtare të Stafit në IES ABASTOS, Valencia, Spanjë, për periudhën 7-14 prill 2025.

Bazuar në komunikimin me postë elektronike zyrtare me institucionin pritës, Universiteti I Gjirokastrës do të përfaqësohet me 6 pozicione që përfshijnë përkatësisht 2 anëtarë të stafit akademik dhe 4 anëtarë të stafit administrativ.

Të interesuarit të dërgojnë në mënyrë elektronike dhe fizike, pranë Sektorit të Koordinimit Ndërkombëtar, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **14.03.2025**:

- Kontratë pune;
- Letër interesi në anglisht;
- CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS CV në anglisht;
- provë / certificate të njohurive të gjuhës angleze minimalisht të nivelit B2;
- fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit.

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision *ad hoc* i ngritur pranë UGJ-së dhe më pas ky vlerësim do t'i përcillet palës partnere, për për zgjedhjen përfundimtare të aplikantëve.

Zv/Rektor
Prof. asoc. Merita ISARAJ



Adresa: Lagjia "18 Shtatori", Rruga "Studenti", Gjirokastrë 6001, Tel: 084263408 web: www.uogj.edu.al